

CV – Diana Çuli

I

Diana Çuli ka lindur në Tiranë ku ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Punët:

Në vitet 1974-1990 ka punuar si gazetare në gazetën kulturore-letrare DRITA dhe më pas në revistën *Les Lettres Albanaises*, ku botohej letërsi shqipe në gjuhën frënge. Të dyja ishin organe kulturore dhe letrare të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Me ardhjen e sistemit demokratik Diana Çuli u angazhua me shoqërinë civile, me lëvizjen e gruas dhe u zgjodh Presidente e *Forumit të Pavarur të Gruas Shqiptare*, një organizatë e vlerësuar me çmimin e lartë të Bashkimit European për *Kontributin në fushën e të drejtave të grave*.

Në vitet 2005-2009 u zgjodh deputete në Parlamentin Shqiptar, duke përfaqësuar zonën e Përmetit.

Botime:

Vëllime me tregime:

Jehonat e jetës;

Ditët e Teutës;

Sheshi i Spanjës,

Romane:

Zëri i largët,

Rrethi i kujtesës,

Dreri i Trotuareve,

Rekuiem,

Dhe nata u nda në mes,

Diell në mesnatë,

Engjëj të armatosur,

*Gruaja në kafe,
Hoteli i Drunjtë.
Vrasje në kryeministri*

Skenarë për filma artistikë:

Hije që mbeten pas – bazuar në romanin *Zëri i largët*, regjia Esat Mysliu.

Rrethi i Kujtesës – bazuar në romanin me të njëjtin titull, regjia Esat Mysliu.

Bregu i ashpër, - regjisore Drita Bregu

Dashuri Europiane: film serial – artistiko-edukativ – regjia Ylli Pepo, prodhim i RTSH.

Romani *Dreri i trotuareve* ka qenë pjesë e leximeve letrare në programet shkollore për 15 vjet.

Romanet *Diell në mesnatë* dhe *Engjëj të armatosur* janë botuar në gjuhën italiane nga shtëpia botuese italiane *BESA*. Romani *Gruaja në kafe* është botuar në Maqedoni. Mjaft tregime dhe novela të Diana Çulit janë botuar në Francë, Rusi, Kanada, Maqedoni, Bullgari dhe në Kinë

Botime të tjera: 120 artikuj, rubrika, studime lidhur me letërsinë, artet e kulturën, barazinë gjinore etj. në organe të ndryshme të shtypit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Më e njohura: *Ese për gruan Shqiptare*, Shtëpia Botuese *Dora D'Istria* 2000, 2003, 2005.

Përkthime:

Nga anglishtja:

Fareed Zaharia, Barrington Moore, Elisabeth Gilbert, John Irving, etj.

Nga frengjishtja: Jean-Paul-Sartre, Simone de Beauvoir, Irene Nemirovski, Mark Levi, Patrick Modiano, Andre Gide, Ana Gavalda, etj.

Nga italishtja: Umberto Eco, Alberto Bevilacqua, Oliviero La Stella, Carmine Abate, Federico Moccia, etj.

II

Përvoja në fushën e gazetarisë, medias audiovizive dhe asaj të shkruar:

Para vitit 1991 :

- Gazeta *Studenti* : (sekretare e kolegjumit) – organ i studentëve të Universitetit Shtetëror të Tiranës.
- Gazeta *DRITA* dhe revista *Les lettres Albanaises* – organe të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë.
E pranishme gjatë viteve 1975 – 1990 në emisione kulturore të RTSH dhe të Radio Tiranës.

Pas vitit 1991 :

- **Bashkëpunëtor** e portalit TIRANA – POST – **2018 - 2019**
- **Autore** e rubrikës LIBRI – në suplementin letrar të gazetës MAPO, **2016-2017**.
- **Moderator** e Emisionit *Kronikë e Pambaruar* – emision kulturor i televizionit Ora News – si bashkëpunëtor e jashtme, **2013-2019**
- **2014-2018** – anëtar e bordit të Arkivit të Filmit Shqiptar (AQSHF)
- **Anëtar** e Këshillit Etik të RTSH.
- **2005 – 2009** - Anëtar e komisionit të medias, kulturës dhe arsimit në parlamentin shqiptar. Anëtar e këtij komisioni në delegacionin shqiptar në Strasburg.

- **1991 – 2005:** Drejtore e revistave *Gruaja dhe Koha* dhe *Penda e Gruas* – organe të Forumit të Pavarur të Gruas Shqiptare.

Për veprimtarinë e saj letrare Diana Çuli është vlerësuar me Urdhërin “Naim Frashëri” të klasës III, 1988; me çmimin e parë të Jurisë Mesdhetare për *Letërsinë Femërore* në Marsejë, 1996; me çmimin e parë të Jurisë Franko-Shqiptare në Paris për dramën NEMESIS; me çmimin *Shkrimtarja më e mirë e vitit* për romanin *Engjëj të armatosur*, në vitin 2007 nga komisioni i Panairit të Librit; me çmimin *Përkthyesja më e mirë e vitit*, nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë në vitin 2017, etj.

Është vlerësuar edhe me Urdhërin OMRI të Republikës Italiane, dhënë nga Presidenti Napolitano, për kontributin e dhënë në shkëmbimet sociale e kulturore midis dy vendeve.

Shënim: Në dokumentat zyrtare është e regjistruar si Diana Çuli Sinoimeri, duke mbajtur edhe mbiemrin e bashkëshortit pas martesë. Çuli është mbiemri i familjes së saj. Në letërsi dhe gazetari është njohur si Diana Çuli, por shpesh edhe në dokumente të ndryshme, pavarësisht regjistrimit në gjendjen civile, është shënuar vetëm mbiemri i saj i parë, Çuli, si për shembull në pasaportat e viteve 1991- 2000.